



Përmbledhje e meditimeve rreth ajeteve kuranore

Përktheu dhe përshtati
Dr. Flamur Kabashi

2024

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar, i Cili e zbriti Kuranin dhe e bëri mrekulli të të gjitha kohërave. Kurani është Fjalë e Zotit Fuqiptotë, të Dijshmit, është Libër i përsosur e nuk ka dyshim në të, është i begatë, të cilit nuk i harxhohen mësimet, e as nuk ngopen lexuesit me të. Përpos leximit të Kuranit Fisnik, Allahu e kërkon nga ne edhe meditimin apo përsiatjen e ajeteve kuranore. Allahu thotë: **“Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të mendarët.”** (Sad, 29). Frymëzuar nga ajeti i lartpërmendur rrjedhë ky punim, përmes së cilit kam bërë përmbledhjen e meditimeve të shumta, të dijetarëve apo të lexuesve të ndryshëm, rreth ajeteve kuranore. Meqë këto shkrime i kisha të shpërndara, vendosa t’i tuboj në një punim.

Terminologjinë e përdorur: “përkthim” do të thotë se e kam përkthyer komplet tekstin nga arabishtja, “përshtatje” do të thotë se shkrimin në fjalë, kam bërë ndërhyrje në të, duke e përshtatur apo rregulluar që të jetë më e kuptueshme në gjuhën shqipe. E nëse pas ndonjë mësimi apo këshille, nuk shkruan asgjë, atëherë thënia në fjalë është e imja. E lusim Allahun e Madhëruar të na e bëjë Kuranin dritë të zemrave tona e të na e mundësojë të jetojmë me të, derisa të dalim para Tij.

* Në fillim të Kuranit kemi: **“Falënderimi i takon Zotit të botëve.”**
(Fatiha, 2)

Kurse në fund të Kuranit kemi suren Nas, përmes së cilës kërkohet mbrojtja e Allahut kundër cytjeve të njerëzve e të shejtanëve.

Pra në fillim e falënderojmë Allahun për çdo gjë, e sidomos për udhëzim, kurse në fund kërkujmë mbrojtjen e Tij, nga cytjet e njerëzve e të shejtanëve që mos të na lajthitin nga ky udhëzim.

Përshtatje

* **“Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit, të cilët besojnë në të fshehtën, falin namazin dhe japin prej asaj që u kemi dhënë Ne.”** (Bekare, 2,3)

“Japin prej asaj që u kemi dhënë Ne,” pra japin diç prej pasurisë që ua ka dhënë Allahu. Shprehja “prej” tregon se Allahu kërkon nga ne, vetëm një pjesë të pasurisë, që të mos dëmtohem. Prandaj nëse japim diç “prej pasurisë” edhe ne përfitojmë, edhe vëllezërit tanë.

Për ta kuptuar më mirë. Pjesa e ajetit nuk po thotë: “japin pasurinë që u kemi dhënë Ne,” sepse kështu do të kuptohej se duhet ta japin tërë pasurinë, e që kjo nuk është e kërkuar.

Gjithashtu kjo pjesë: **“Japin prej asaj që u kemi dhënë Ne,”** nuk kufizohet vetëm me dhënien e pasurisë, porse edhe të dijes, autoritetit, mundit, e të mira tjera që ua ka dhënë Allahu.

Përshtatje

* Allahu i Madhëruar na e tregon gjendjen e hipokritëve (munafikëve):

“Në zemrat e tyre ka një sëmundje.” (Bekare, 10)

Dihet se i sëmuri kur konsumon ndonjë ushqim, shija i duket krejtësisht tjetër nga shija reale që e ka ai ushqim; p.sh. ushqimi i ëmbël i duket i hidhët.

Kështu është puna e hipokritit (munafikut), e vërteta i duket e kotë, kurse e kota e vërtetë.

Përktim

* **“Dhe njerëzve u thoni fjalë të mira.”** (Bekare, 83)

“Njerëzve” pa dallim, me rëndësi është që fjalët me qenë të mira, e nuk është kusht që personi të cilit i flasim të jetë i mirë.

Ajeti ka ardhur me shprehjen “husna” pra fjalë të mira, por është edhe një lexim tjetër i këtij ajeti: “hasanen” i cili ka një kuptim shtesë; fjalë të mira së bashku me pamje të mirë dhe në formën më të mirë (më butësi, ëmbëlsi etj.).

Përktim

* **“Dhe njerëzve u thoni fjalë të mira.”** (Bekare, 83)

Jam i bindur se shumë prej nesh e kemi lexuar këtë ajet.

A e dini se ky ajet i përfshinë: prindërit, burrin, gruan, vëllain, motrën, vjehrrin, vjehrrën, nusen, fqinjin etj.

O vëlla, nëse babës nuk i flet fjalë të mira, të lutem mos e vazhdo hatmen (leximin e tërë Kuranit). Ndal te ky ajet!

Nëse gruas ia rëndon ditën me fjalë të vrazhda, të lutem ndalu!

Oj motër, nëse burrin e shqetëson me fjalët tua, të lutem ndalu!

Nëse vjehrrën e zemëron me fjalë, të lutem ndalu!

Nëse nusen e thumbon me fjalë, të lutem ndalu!

Të betohem në Allahun, mos e vazhdo leximin e Kuranit. Ndal te ky ajet! Puno me këtë ajet, e pastaj vazhdo me mësimet tjera!

Kurani nuk ka ardhur vetëm t’i rrotullojmë fletët, e t’i numërojmë hatmet, por edhe të jetojmë me Kuran.

* **“Kur Ibrahim dhe Ismaili ngritën themelet e Qabes, u lutën: “O Zoti ynë! Pranoje prej nesh (këtë vepër)! Me të vërtetë, Ti je Ai që dëgjon dhe di gjithçka!”** (Bekare, 127)

Gjatë ndërtimit të Qabesë ishin vetëm këta dy; pa kamera, pa shikues, pa rrjete sociale, megjithatë luteshin që t’u pranohet ky shërbim që ia

bënin Shtëpisë së Zotit.

Shtoji bamirësitë, pakësoji fotot! Bëhesh i paharruar.

* **“(Kjo fe është) ngjyrosje e Allahut.”** (Bekare, 138)

Allahu e quajti fenë “ngjyrosje”, ngase veprat, morali, edukata etj., shfaqen dhe duken në jetën e muslimanit, ashtu sikurse duket dhe dallohet ngjyra në rroba.

Përktim

* **“Ne do t’ju sprovovjmë me diç prej frikës e urisë.”** (Bekare, 155)

Fjala “me diç” aludon në gjë të vogël, ngase sprova ka për qëllim pastrimin e assesi shkatërrimin.

Përktim

* **“Dhe mos i pasoni hapat e shejtanit.”** (Bekare, 168)

Shiko fjalën “hapat”, në të kemi dy aludime:

1. Hapat kanë largësi të vogël mes veti, kështu edhe shejtani fillon me gjëra apo mëkate të vogla.
2. Hapat është shumës, e nuk po thotë: hapin. Shejtani nuk ndalet në mëkatën e parë, por vazhdon me mëkate sikurse bërja e hapave.

Përktim

* Urdhrat a Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Kur po janë në pyetje disa obligime fetare, si bie fjala: Mblesa për vajzat, namazi për djemtë, xhumaja për punëtorët, etj. po ndodh që disa muslimanë, sikur po u dhimbsen këto kategori dhe kërkojnë lehtësime për ta.

I dëgjojmë fjalët: “Herët me e vendosë shaminë! I ri me u fal! S’po mundet me e lënë punën”...

Nuk ka mundësi t’i mëshirojmë ne e t’ua duam të mirën atyre, më shumë sesa Mëshiruesi, i Dijshmi, Ai i cili ka Urtësi absolute.

“E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njuh çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithëinformuari?!” (Mulk, 14)

“I Dërguari është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëritjetrin.” (Ahzab, 6)

“Allahu nuk dëshiron t’ju sjellë ndonjë vështirësi.” (Maide, 6)

“Allahu dëshiron që t’jua lehtësojë dhe jo që t’jua vështirësojë.” (Bekare, 185)

* Allahu i Madhëruar në kontest të përmendjes së zbritjes së Kuranit në muajin Ramazan dhe të disa dispozitave të agjërimit, ajetin e përfundon me këto fjalë: **“Që të falënderoni.”** (Bekare, 185)

Dr. Muhamed el-Hamed në lidhje me falënderimin e thotë një fjalë të

bukur: Me falënderim i ruan begatitë që i ke dhe i kap ato që nuk i ke.

* Në kaptinën Bekare pas ajeteve të agjërimit, vjen një ajet që flet për një lloj tjetër të “agjërimit”, e që është mos ngrënia e pasurisë së tjetrit me mashtrim, vjedhje etj.

“Dhe mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të pa lejuar.”
(Bekare, 188)

Agjërimi i vërtetë; të mos hamë e të mos pimë, na mëson edhe të mos e prekim pasurinë e tjetrit; qoftë ajo pasuri e shtetit, e fqinjit, e punëtorit, e kompanisë, apo e kujtdo tjetër.

Përshtatje

* Në Kuran përmendet personi i cili pyeti rreth ringjalljes, atëherë:
“Allahu e bëri të vdekur për njëqind vite, e pastaj e ringjalli atë.”
(Bekare, 259)

Njëqind vite për ta mësuar një mësim të bazave të fesë: ringjalljen.

Nganjëherë disa mësimë kërkojnë kohë më të gjatë.

Përktim

* Imam Kurtubiu në tefsirin e tij tregon se një dijetar ishte bamirës

i madh, mirëpo betohej se askujt nuk i kishte bërë mirë. Kur është pyetur pse?

Është përgjigjur: “Unë i kam bërë mirë vetes sime”, pastaj e citoi ajetin “Çfarëdo që të jepni nga pasuria, e keni për veten tuaj.” (Bekare, 272)

Përktim

* **“Ata që japin nga pasuria e tyre (lëmoshë) natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi.”** (Bekare, 274)

Nata është përmendur para ditës dhe fshehurazi është përmendur para haptazi, për të treguar se fshehja e lëmoshës është më e vlefshme sesa shfaqja e saj.

Përktim

* Allahu i Madhëruar u drejtohet huadhënësve me këtë ajet:

“Nëse e dini se borxhliu është ngushtë, shtyjani afatin (e shlyerjes së borxhit) derisa ta përmirësojë gjendjen. Por është më mirë për ju që t’ia falni borxhin, veç sikur ta dinit.” (Bekare, 280)

Shikoje këtë ajet madhështor i cili është plotë mëshirë e bamiresi ndaj të varfrit, i cili nuk ka mundësi ta paguajë borxhin; E urdhëron të pasurinë, t’ia shtyjë afatin, ose t’i falë borxhin.

Krahasoje këtë madhështi me “humanizmin e bankave moderne,” të cilat pasurohen në kurriz të varfërve.

* Surja Ali Imran (familja e Imranit) është quajtur në bazë të kësaj familje të begatshme, e cila ishte simbol për qëndrueshmëri, devotshmëri dhe sakrificë në fe.

Shembujt kryesor në këtë sure janë dy gra:

Gruaja e Imranit, e cila ishte e vendosur që fëmija i saj të jetë në shërbim të fesë.

Merjemja, nëna e Isait ﷺ.

Pra simbol i qëndrueshmërisë në fe, në këtë sure qenka gruaja.

Përktim

* “Ndërsa ata që janë thelluar në dijeni, thonë: “Ne i besojmë (Kuranit). Të gjitha këto (vargje të qarta e alegorike) janë nga Zoti ynë!” Këtë e kuptojnë vetëm mendarët. (Ata thonë:) “O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë.” (Ali Imran, 7, 8)

Lutja e atyre që janë të thelluar në dije qenka: “O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta).”

Njeriu pasi ta shijon udhëzimin, sa më shumë që ka dije, frikohet më tepër nga lajthitja.

Përshtatje

* Zekerija ﷺ pasi e pa furnizimin që i vinte Merjemes nga Allahu, menjëherë u frymëzua për lutje:

“Atëherë Zekerija iu lut Zotit të vet e tha: “Zoti im! Dhuromë nga ana Jote një pasardhës të mirë! Se Ti, me të vërtetë, je Dëgjues i lutjes!” (Ali Imran, 38)

Kështu janë njerëzit e mirë, kur ta shohin ndonjë begati tek dikush gëzohen, madje inspirohen të luten për to, kurse ziliqarët vetëm se digjen në vete.

Bindu se mirësitë e Zotit nuk janë të kufizuara në disa persona, ka mjaftë edhe për ty!

Përshtatje

* **Vlera e dhikrit**

Pasi që Allahu e përgëzoi Zekerijanë me djalin Jahjanë, Zekerija ﷺ tha: **“O Zot ma bëjë një shenjë. Ai tha: Shenja jote është që mos tu flasësh njerëzve tri ditë, vetëm se me gjeste, e ti përmende shumë Zotin tënd.”** (Ali Imran, 41)

Shiko: Edhe pse e ndaloi të flasë, e urdhëroi ta përmend shumë Zotin.

Përkthim

* Është shumë e rëndësishme të jemi të bashkuar me trupa, por më e rëndësishme se kjo është bashkimi i “zemrave” edhe nëse trupat janë larg mes veti: **“Përkujtojeni begatinë e Allahut ndaj jush, kur ju ishit të armiqësuar, e Ai i bashkoi zemrat tuaja.”** (Ali Imran, 103)

Përkthim

* **“Nxitoni kah falja e Zotit tuaj dhe Xheneti.”** (Ali Imran, 133)

Maturia është e kërkuar në çdo gjë, përpos për gjërat që të afrojnë tek Allahu, aty nxito.

Përkthim

* Surja Nisa flet për dispozita të shumta, e sidomos për jetimët, gratë, trashëgiminë, martesën, etj. Ajo që është e shprehur në këtë sure është përmendja e shpeshtë e dy emrave të Allahut të Madhëruar: **“El-Alim”** (i Dijshmi) dhe **“El-Hakim”** (i Urti).

Kjo do të thotë se këto dispozita janë prej të Dijshmit, i Cili e di se çka u duhet njerëzve, andaj këto dispozita janë të përkryera. Po ashtu ato janë prej të Urtit, i Cili çdo gjë e bënë me urtësinë më të plotë.

Përkthim

* **“Allahu me të vërtetë, është përherë mbikëqyrës i juaji.”** (Nisa, 1)

Si mundesh të shikosh në haram, kur Allahu përherë të shikon ty!?

Përshatje

* **“O ju njerëz! Kine frikë Zotin tuaj, i Cili ju krijoi prej një individi, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij.”** (Nisa, 1)

Allahu e krijoi Ademin ﷺ, e pastaj prej tij e krijoi Havanë.

Gruaja qenka pjesë e burrit, andaj duhet të jetë prehje dhe qetësi për burrin, e assesi ta çojë kokën mbi të.

Përktim

* Në suren Nisa, që është nga suret më të gjata, mu në fillim të sures, Allahu thotë:

“Jetimëve, kur të rriten ua jepni pasurinë e tyre.” (Nisa, 2)

Nën hijen e Islamit, edhe pse je i dobët, nuk të cenohet haku yt.

Përktim

* **“Me të vërtetë Allahu pranon pendimin vetëm prej atyre të cilët bëjnë ndonjë vepër të keqe nga mosdija dhe shpejt pendohen.”**

(Nisa, 17)

“Nga mosdija”: personi që bën mëkat, nuk e di rrezikun e mëkatit, por edhe nuk e di Madhështinë e Atij që po i bënë mëkat.

Çdo mëkat që e bënë njeriu, qoftë me qëllim apo pa qëllim, konsiderohet **“mos dije”**.

Përshtatje

* **“Ndhmoni njëri-tjetrin në bamirësi dhe devotshmëri.”** (Maide, 2)

Me devotshmëri arrihet kënaqësia e Allahut, kurse me bamirësi arrihet kënaqësia e njerëzve, ndërkaq ai që i bashkon që të dyja, do të jetë i lumtur.

Përkthim

* **“Le të mos u nxis juve urrejtja ndaj një populli për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se drejtësia është më afër devotshmërisë.”** (Maide, 8)

Dije se i fort je kur të jesh i drejtë, e jo kur të bësh zullum.

Përkthim

* Allahu i Madhëruar për një grup të njerëzve thotë:

“Allahu i shpërbleu ata, për atë që thanë.” (Maide, 85)

Ndërsa për një grup tjetër thotë: **“U mallkuan për atë që thanë.”**
(Maide, 64)

Edhe grupi i parë **“thanë,”** e edhe grupi i dytë **“thanë,”** porse me “fjalë” dikush fitoi shumë dhe me “fjalë” dikush humbi shumë.

Mos e shpërfill asnjë fjalë që e flet.

Përktim

* Kurani Fisnik na i përmend fjalët e Isait ﷺ drejtuar Allahut të Madhëruar: **“Nëse Ti i dënon ata, ata janë robërit e Tu, e nëse i fal, vërtetë Ti je Krenari (el-Aziz) dhe i Urti (el-Hakim).”** (Maide, 117)

Zakonisht ajetet e tilla përfundojnë me: Ti je Falësi (el-Gafur) dhe Mëshiuësi (er-Rahim).

Dijetarët thonë: Këtu ka ardhur **Krenari** ngase faljen që ua bënë robërve të Vet, nuk e bënë nga dobësia apo se nuk mund t'i dënojnë, Ai ka mundësi për këtë, porse këtë falje e bënë me Krenari dhe me Urtësinë e Tij absolute.

Prandaj falja e vërtetë mes njerëzve, është atëherë kur njeriu është i fuqishëm dhe ka mundësi të hakmerret, porse faljen e bënë me krenari, sepse ka shpirt të madh.

* Allahu i Madhëruar e dënoi popullin e Lutit ﷺ dhe tha: **“Ne e shpëtuan atë (Lutin) dhe familjen e tij, pos gruas së tij që mbeti aty (ndër të shkatërruarit).”** (Araf, 83)

Gruaja e Lutit ﷺ si jobesimtare që ishte, nuk e bënte veprën e ndytë që e bënin populli i saj, megjithatë i “përkrahte” ata, andaj u ndëshkua me ta.

Përktim

* **“Atëherë (për shkak të mohimit) Ne lëshuam kundër tyre: vërshimin, karkalecat, rriqrat (insekte dëmtuese), bretkosat dhe gjakun, fakte të gjalla njëra pas tjetrës, por ata u bënë mendjemëdhenj dhe ishin mëkatarë.”** (Araf, 133)

Është e çuditshme! Mendjemadhësia në esencë është e keqe dhe e pahijshme, porse pas shenjave dhe argumenteve të Zotit, prapë të mbahet koka lartë, është shumë e paarsyeshme. Sa shumë që duron Allahu!

* Musai ﷺ u hidhërua shumë me veprën e keqe të popullit të tij, sa që e kapi për koke vëllain Harunin ﷺ, por ai, ia tha Musait një porosi shumë të madhe: **“Ata gati sa nuk më mbytën, e ti mos i gëzo armiqtë me mua.”** (Araf, 150)

Sikur po i thotë: Mos më kap për koke në prani të tyre sepse ata gëzohen kur të na shohin kështu.

Përçarja e besimtarëve në prani të armikut i gëzon ata.

Përshtatje

* Allahu i Madhëruar e ka bërë dallimin mes “fukarave” (të varfërve) dhe “miskinëve” (nevojtarëve). Allahu thotë: **“Zekati u takon vetëm të varfërve e nevojtarëve...”** (Teube, 60)

“Fukuratë” s’kanë fare apo kanë shumë pak.

“Miskinët” e kanë gjendjen më të mirë se fukuratë, porse të hyrat mujore që i kanë, nuk u mjaftojnë për harxhimet elementare, për një jetë mesatare.

P.sh: Nëse një familje me pesë anëtarë, të hyrat mujore i kanë vetëm 250-300 euro (që i bie për person vetëm 50-60 euro), atëherë themi se këtyre lejohet t’u japim e t’ua lehtësojmë gjendjen, sepse të hyrat që i kanë nuk u mjaftojnë për një jetë mesatare. Gjendja rëndohet edhe më shumë në rast se kanë borxhe, apo kanë ndonjë të sëmurë, apo banojnë me qira etj.

* **“Ka edhe të tjerë, që i kanë pranuar mëkatet e veta: Ata përzier vepra të mira, e edhe të tjera të këqija. Allahu do t’ua fal atyre.”** (Teube, 102)

Nëse nuk mundesh t’i lësh të gjitha të këqijat, të paktën angazhohu t’i shumëfishosh të mirat, ngase të mirat i fshijnë të këqijat.

Përktim

* **“Ata të cilët e pasuan në momentin e vështirë...”** (Teube, 117)

Beteja e Tebukut në këtë ajet po quhet si “moment i vështirë.” Nga ky ajet kuptojmë se sprovat e mëdha qenkan vetëm momente dhe për pak kohë përfundojnë.

Përshatje

* Mësime nga surja Junus:

Së pari: I tërë populli i kanë besuar Junusit ﷺ.

Së dyti: **“Nëse ke dyshim në këtë që ta kemi zbritur ty, pyeti ata që lexojnë librin para teje...”** (Junus, 94) Nga ky ajet kuptojmë: Nëse njeriut i vijnë dyshimet në fe, atëherë ai duhet të kthehet tek dijetarët dhe t’i pyes ata.

Së treti: **“Atyre që bëjnë vepra të mira, u takon e Mira e edhe më tepër.”** (Junus, 26) Pejgamberi ﷺ në lidhje me këtë ajet ka thënë: “E Mira: është Xheneti. Kurse edhe më tepër: Është shikimi në Fytyrën Fisnike të Allahut.” (shënon Muslimi).

Përkthim

* Mësime nga surja Junus, sikur të ishin zbritur tani.

Së pari: Në kohën më të vështirë, në kohën e frikës dhe të provës së madhe që e përjetonin benu israilët nga faraoni, Allahu i Madhëruar

iu drejtua atyre me këtë porosi: **“Ne ia kemi shpallur Musait dhe vëllait të tij: Ndërtoni shtëpi për popullin tuaj në Egjipt, bëjini ato kible (faltore) e faleni namazin! Dhe përgëzoni besimtarët!”** (Junus, 87). Kjo porosi ishte pak para fitores së madhe, para çarjes së detit, para përmytjes së simbolit të zullumit, faraonit.

Së dyti: Musai ﷺ u lut kundër faraonit dhe parisë së tij, e me atë rast Allahu i tha: **“Lutja juaj është pranuar, prandaj ju të dy qëndroni (në rrugën e drejtë) e mos ndiqni rrugën e atyre që nuk dinë!”** (Junus, 89). Shumë njerëz në kohëra të vështira pendohen, luten e këndellen dhe Allahu iu përgjigjet atyre. Këtu s’ka gjë të keqe, porse Allahu po kërkon nga besimtarët “të qëndrojnë në rrugë të drejtë,” ta vazhdojnë këtë rrugë edhe pas largimit të vështirësisë.

Së treti: Allahu i Plotfuqishëm, pasi e përmyti faraonin dhe ushtrinë e tij, trupin e tij e la si shenjë dhe si argument madhështor për njerëzit, ashtu që ta shohin me sytë e tyre dhe të marrin mësim nga ai. Allahu i Madhëruar thotë: **“Sot po të shpëtojmë ty (po të nxjerrim prej detit) me trupin tënd (të vdekur), që të shërbesh si argument për ata që vijnë pas teje. Vërtetë, shumë njerëz janë të shkujdesur ndaj argumenteve Tona.”** (Junus, 92).

Transmetohet nga Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se disa persona nga benu israilët ende dyshonin në vdekjen e faraonit, andaj Allahu e urdhëroi detin që ta nxjerr trupin e tij, të vdekur.

Shenjat e Allahut që kanë kaluar apo edhe të tashmet, përpos që janë mësim për ne, janë mësim edhe për brezat e ardhshme. Megjithatë ka prej njerëzve që ende janë në dyshime, ende nuk janë këndellë, apo

ndoshta e presin zbulimin e perdes, porse atëherë behet vonë.

* Një pjesë e madhe e sureve të gjata, fillimi i tyre është i ngjashëm me përfundimin. Shembull:

Surja Hud: Në fillim të sures ka ardhur urdhri për adhurim: **“Mos adhuro tjetër pos Allahut.”** (Hud, 2). Ndërkaq përfundimi i saj është **“Adhuroje Atë dhe mbështetu tek Ai.”** (Hud, 123)

Surja Jusuf: Në fillim të saj kemi: **“Ne ta rrëfejme ty tregimin më të mirë.”** (Jusuf, 3) Ndërkaq në fund të kësaj sure kemi: **“Në tregimet e tyre kishte mësim.”** (Jusuf, 111)

Përshtatje

* Nuhu ﷺ, gruan e kishte jobesimtare: **“Për ata që nuk besojnë, Allahu sjell shembull, gruan e Nuhut.”** (Tahrim, 10)

Edhe populli i tij: **“Pak ka pasur që besuan me të.”** (Hud, 40)

Megjithatë, Nuhu ﷺ: **“Vërtet ai (Nuhu) ishte rob shumë falënderues.”** (Isra, 3)

Falënderimi ndaj Allahut, nuk duhet të lihet për shkak të rrethit të keq.

Përshtatje

* **“Kur erdhi urdhri Ynë (dënimi), Ne me mëshirën Tonë e shpëtuam Salihun bashkë me besimtarët e tij.”** (Hud, 66)

Kur Allahu të shpëton nga ndonjë e keqe, mos thuaj: Për shkak të sadakasë sime, për shkak të namazit, për shkak të qëllimit të mirë që kisha.

Por thuaj: Allahu më shpëtoi me Mëshirën e Tij.

Përkthim.

* Luti ﷺ iu drejtua popullit me këto fjalë:

“A nuk ka ndër ju ndonjë njeri të mençur (rashid)?!” (Hud, 78)

Fjala “rashid” d.m.th. i mençur, i pjekur, i kuptueshëm, i drejtë.

Nga kjo kuptojmë se zhytja në mëkate, përveç që e dobëson fenë, e dobëson edhe mendjen dhe e zbeh burrërinë.

Përkthim

* **“(Jakubi i tij) tha: “O biri im! Mos u trego ëndrrën tënde vëllezërve tu, që mos të ta bëjnë ndonjë dredhi. Se, me të vërtetë, djalli është armik i hapët i njeriut.”** (Jusuf, 5)

Ai që xhelozon, edhe ëndrrat e tjetrit e pengojnë; e pengon vizioni, planet dhe projektet që i ka dikush, e mos të flasim për begatitë e tjera.

Kujdes! Mos shpalos krejt çfarë ke në mendje.

Përshtatje

* **“Njëri prej tyre tha: Mos e mbytni Jusufin.”** (Jusuf, 10)

Thjeshtë, ishte vetëm propozim, porse bëri ndryshime në histori.

Mos e nënçmo asnjë ide apo mendim, se ndoshta gjurmët e mira që i lë pas, mund të jenë marramendëse.

Përkthim

* Dhjetë vëllezërit e morën me vete Jusufin ﷺ, pastaj: **“Pasi e morën, (unanimisht) vendosën që ta hidhnin në fund të një pusi.”** (Jusuf, 15)

Dhjetë vëllezërit e Jusufit ﷺ u bashkuan në “një mendim” për këtë vepër të shëmtuar, kurse sot vështirë të gesh një grup prej dhjetë personave të cilët “të gjithë pa përjashtim” janë të një mendimi për një projekt të mirë.

* **“Kështu, Ne i shpërblejmë bamirësitë.”** (Jusuf, 22)

Jusufit ﷺ iu është dhënë gjysma e bukurisë, megjithatë Allahu nuk e lavdëroi për bukuri, porse për bamirësi.

Përkthim

* Jusufit ﷺ i thanë: **“Ne të shohim se qenke bamirës.”** (Jusuf, 36)

Në çfarë rrethane ia thanë këtë? Duke qenë në burg. Po në burg ishte bamirës, me ato pak mundësi që kishte, bënte mirë; e vizitonte të sëmurin, nëse dikush kishte ndonjë nevojë, tubonte për atë nevojtar.

* Jusufi ﷺ ia la një porosi njërit prej dy shokëve të burgut: **“Dhe atij nga ata të dy, për të cilin mendonte se do të shpëtojë, i tha: “Lajmëroje zotërinë tënd për mua.” Mirëpo shejtani ia mori mendjen e ky harroi ta përmend tek zotëria i vet dhe ai (Jusufi) mbeti në burg disa vjet.”** (Jusuf, 42)

E pra kuptoje se t’i harrosh të dashurit dhe shokët është prej shejtanit.

Përkthim

* Mësime prej thesarit të sures Jusuf:

Së pari: Disa njerëz e lavdërojnë meritoren, të zellshmin, të ndershmin, por ka të tillë që flasin keq për të.

Së dyti: Fjalët e mira dhe lavdërimet mbesin të përjetshme, ndërsa gënjeshtra shpaloset shpejtë.

Së treti: **“Gruaja e ministrit tha: Tani doli në shesh e vërteta.”**
(Jusuf, 51)

E vërteta mund të bie në gjumë, por assesi të vdesë.

Përkthim

* Në suren Jusuf, Allahu i tregon fjalët e mbretit të Egjiptit për Jusufin ﷺ: **“Mbreti tha: “Ma sillni atë, do ta marr si këshilltar personal.” Jusufi tha: “Më cakto të udhëheq thesarin e vendit.”** (Jusuf, 54, 55)

Mbreti deshi ta bëjë këshilltar personal, por Jusufi ﷺ deshi që dobia e tij të jetë për të gjithë popullin.

Përkthim

* Allahu i Madhëruar në momentet më kritike të Merjemes iu drejtua me këto fjalë: **“Ha e pi dhe qetësohu”** (Merjem, 26)

Robërve të Vet iu drejtua me: **“Mos u dëshpëroni prej Mëshirës së Allahut!”** (Zumer, 53)

Jakubi ﷺ u tha bijve të tij: **“Mos u dëshpëroni!”** (Jusuf, 87)

Jusufi ﷺ i tha vëllait të tij: **“Mos u pikëllo!”** (Jusuf, 69)

Shuajbi i tha Musait ﷺ: **“Mos u frikëso!”** (Kasas, 25)

Muhamedi ﷺ i tha Ebu Bekrit: **“Mos u mërzit!”** (Teube, 40)

Mbjellja e qetësisë shpirtërore është “Metodologji Hyjnore,” që e praktikonin Pejgamberët, andaj praktikoje edhe ti!

Përkthim

* Kurani na flet për pikëllimin e Jakubit ﷺ që e kishte për Jusufin ﷺ:
“**Dhe sytë iu zbardhën nga pikëllimi.**” (Jusuf, 84)

Po thotë sytë e Jakubit (për të birin), e jo të Jusufit (për babanë).

O bir, a e kuptove dallimin?!

Përktim

* Diç prej thesarit të sures Jusuf:

Së pari: Kërkimi i faljes prej të riut është më e lehtë sesa prej të moshuarit; Shikoje përgjigjen e Jusufit ﷺ, në momentin kur vëllezërit i kërkuan falje atij, ai u tha: “**Sot nuk ka qortim për ju.**” (Jusuf, 92). Ndërkaq përgjigja e babait të tyre (Jakubit) ishte: “**Më vonë do të kërktoj falje për ju.**” (Jusuf, 98)

Së dyti: “**Gratë në qytet thanë: Gruaja e ministrit po i vërsulet shërbëtorit të saj.**” (Jusuf,30).

Shiko, nuk po e quajnë me emrin e saj, porse ia bashkëngjiten burrit të saj, ngase kishin për qëllim përhapjen e lajmit. Kjo praktikohet me njerëzit që kanë pozita, nuk i përmendet emri, porse pozita e tij, në mënyrë që të bëhet më e madhe.

Përktim

* Ibrahim عليه السلام është lutur: **“Dhe më bashko me të mirët!”** (Shuara, 83). Po ashtu Jusufi عليه السلام është lutur: **“Dhe më bashko me të mirët!”** (Jusuf, 101)

Derisa të zgjedhurit e Allahut luten të jenë së bashku me të mirët dhe gjithmonë në mendje i kanë njerëzit e mirë, ende ka prej neve që gjurmojnë për të metat e burrave të mirë.

Përkthim

* Prej mësimëve të tregimit të Jusufit عليه السلام kemi:

Sprovat e ngritin besimtarin, saqë dijetarët kanë thënë: Sikur ta dinte shejtani se çfarë përfundimi të mirë do të ketë Jusufi عليه السلام, nuk do t'i nxiste vëllezërit për ta hedhur në bunar, ashtu që të mbetej i pa përmendur dhe tregimi i tij mos të fillonte fare.

Përkthim

* Pasoje Jusufin عليه السلام!

Edhe pse ishte në fron, e në dorë kishte depot e shtetit, me një fjalë udhëheqjen e shtetit e kishte ai, megjithatë ëndrra e tij ishte kjo lutje: **“Më bëj të vdes musliman dhe më bashko me të mirët!”** (Jusuf, 101)

Përkthim

* Jusufin ﷺ e xhelozuan, e hedhën në bunar, e dëbuan prej shtëpisë, e burgosën, e akuzuan për vjedhje.

Vetëm se ishte i mirë. Vetëm se ishte i dalluar dhe prej tij pritej një e ardhme e ndritshme.

Përktim

* Edhe mrekullitë e Allahut bëhen me sebeb (shkak);

Nëna e Musait ﷺ nuk e hodhi atë drejtë në ujë, porse fillimisht e futi në kuti e pastaj e hodhi në ujë.

Allahu e urdhëroi Musain ﷺ që ta godas ujin me shkop, e pastaj ai u nda në dy pjesë.

Merjemen e urdhëroi që ta shkund trungun e palmës, e t'i bien hurmat.

Jusufi ﷺ u tha vëllezërve që t'ia hedhin këmishën Jakubit ﷺ në fytyrë, e t'i kthehet shikimi.

Allahu të gjitha këto mund t'i bëjë edhe pa sebeb, porse ne duhet ta kuptojmë mirë lidhjen mes sebebve dhe ndihmës së Zotit.

* Trajtimi që Allahu ua bënë njerëzve është ky:

“Po edhe nëse përpiqeni t'i numëroni begatitë e Allahut, nuk

mund t'i llogarisni ato. Vërtetë Allahu është Falës dhe Mëshirues.”
(Nahl, 18)

Pastaj shikoje njeriun, se si i trajton begatitë e Allahut:

“Po edhe nëse përpiqeni t'i numëroni begatitë e Allahut, nuk mund t'i llogarisni ato. Vërtetë njeriu është shumë i padrejtë dhe shumë mohues.” (Ibrahim, 34)

Përshtatje

* Në disa ajete xhinët përmenden para njerëzve:

“Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”
(Dharijat, 56)

“Ne e kemi krijuar njeriun prej një balte të thatë të marrë nga balta e zezë pa formë, kurse para tij kemi krijuar xhinët nga zjarri pa tym.” (Hixhër, 26, 27)

Në këto dy ajete e kuptojmë se xhinët qenkan krijuar para njerëzve, andaj edhe janë përmendur të parët.

Në disa ajete tjera njeriu përmendet para xhinëve;

“Thuaj: “Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhinët për të hartuar një Kuran të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri-tjetrin.”
(Isra, 88)

Pasi është në pyetje oratoria apo stili i lartë gjuhësor, sigurisht se njeriu është më i dalluar në këtë aspekt, andaj edhe është përmendur para xhinëve.

Përshatje

* Pozita e lartë e Muhamedit ﷺ tek Allahu i Madhëruar;

Abdullah ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: “Allahu nuk ka krijuar shpirt më të ndershëm sesa Muhamedin ﷺ. Allahu nuk është betuar në dikë tjetër, përveçse në të:

“Për jetën tënde (Muhamed), s’ka dyshim se ata ishin të humbur në dehjen e tyre.” (Hixhër, 72)”

Allahut i takon të betohet në krijesat e Tij, ndërsa neve jo.

Dërgoni salavate mbi atë, që Allahu u betua në të.

Përktim

* Allahu u tregoi Pejgamberëve nëse mund “të pushojnë” ndonjëherë:

“Shko ti (o Musa) dhe vëllai yt me argumentet e Mia, e mos u shkrehni (lodhni) në të kujtuarit Mua!” (Taha, 42)

“Dhe adhuroje Zotin tënd deri të vijë e vërteta (vdekja).” (Hixhër, 99)

Ky projekt nuk mbaron me Ramazan.

Intensiteti në Ramazan “shtohet”, e pas tij “normalizohet,” porse nuk ndalet.

* **“Mos u bëni si ajo (grua) që e prish tjerrin e saj, pasi ta ketë qëndisur fortë.”** (Nahl, 92).

Ky shembull flet për ata që e japin fjalën, e nuk e mbajnë premtimin. Këtu hyjnë: fjala dhe besa që i japim njëri-tjetrit, por nuk e mbajmë atë. Po ashtu veprat e mira që i bëjmë me sakrificë, e pastaj i prishim ato.

* **“I Lartësuar qoftë Ai që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabesë) gjer në Mesxhidi Aksa, rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar.”** (Isra, 1)

Vendi i mirë, Mesxhidi Aksaja, bëri që edhe rrethi të jetë i mirë.

Po ne, çfarë bëmë që rrethi ynë të jetë i mirë!?

Përshtatje

* **“Qoftë i lartësuar Ai, i Cili, në një çast të një nate, e barti robin e Tij (Muhamedin) prej Mesxhidi Haramit (prej Qabesë) gjer në Mesxhidi Aksa, rrethinën e së cilës e kemi bekuar.”** (Isra, 1)

Mrekullitë që t'i ka dhënë Allahu dhe begatitë e Tij ndaj teje, nuk të

bëjnë më shumë se të jesh rob i Allahut. Madje të mirat e Tij nuk bënë t'i kthesh vetëm se me modesti.

Pejgamberi ﷺ në momentin kur ishte më krenari, gjatë Çlirimit të Mekës, atëherë kur triumfoi ndaj atyre që e dëbuan, hyri me modesti.

* Tek ajeti i respektit të prindërve, Allahu thotë:

“Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i kundërshto, por drejtoju atyre me fjalë respekti.” (Isra, 23)

Muxhahidi ka thënë: Mos i thirr me emra e as me nofka, porse thuaju: O baba im! O nëna ime!

Përshtatje

* **“Dhe mos iu afroni amoralitetit, se ai është shfrenim dhe rrugë e shëmtuar!”** (Isra, 32)

“Mos ia merrni jetën asnjë njeriu.” (Isra, 33)

Shpejtësia e përhapjes së amoralitetit në shoqëri është më e madhe sesa përhapja e vrasjeve, andaj edhe ndalesa e amoralitetit në këto ajete është përmendur para ndalesës së vrasjes.

Përshtatje

* **“A mos vallë do të shkatërrosh veten nga pikëllimi, nëse ata nuk besojnë në këtë Fjalë (Kuran)?”** (Kehf, 6)

Kjo ndjenjë e digjte nga brenda Pejgamberin ﷺ për t'i parë njerëzit në rrugë të Zotit.

Përshtatje

* Në suren Kehf përmendet tregimi i djelmoshave që u strehuan në shpellë për ta ruajtur fenë:

“Kur disa djelmoha u strehuan në shpellë dhe thanë: “O Zoti ynë, na jep mëshirë nga ana Jote.” (Kehf, 10)

Nga ky ajet nxjerrim:

Njerëzit mendjemprehtë i marrin sebetet dhe i lutën Zotit.

Në kohë të fitneve duhet ta shtojmë thirrjen: O Zoti ynë! O Zoti im!

Për shkak të lutjes së tyre, Allahu i theu ligjet fizike; i ruajti ata për tre shekuj.

Përshtatje

* Në tregimin e djelmoshave në suren Kehf, Allahu thotë:

“Ne ua mbyllëm veshët atyre (duke i lënë të flinin) në shpellë për shumë vjet.” (Kehf, 11)

Njeriu gjatë gjumit nuk sheh, ngase sytë i ka të mbyllur, megjithatë veshët i ka të hapur edhe në gjumë, prandaj edhe dëgjon. Kurse tek rasti i djelmohave të shpellës, Allahu ua mbylli edhe veshët, që të mos dëgjojnë për kohë të gjatë dhe të bëjnë gjumë për vite të tëra.

Përshtatje

* Në tregimin e djelmohave në suren Kehf, Allahu thotë:

“Ne i forcua zemrat e tyre.” (Kehf, 14)

Nuk guxojmë të mahnitemi me veten; ‘unë jam mashallah.’

Çështja e zemrës është në Dorë të Allahut. Kërko prej Tij të ta shtojë besimin e të të forcojë në fe!

Përshtatje

* Në tregimin e djelmohave në suren Kehf, Allahu thotë:

“Ti (o Muhamed) do ta kishe parë Diellin kur lindte, se si anohej nga e djathta e shpellës së tyre dhe, kur perëndonte, ata i linte në anën e majtë, ndërkohë që ata gjendeshin në mesin e saj. Kjo është nga shenjat e Allahut.” (Kehf, 17)

Djelmohat besimtarë ishin në gjumë të thellë, ndërkaq edhe dielli ishte pjesëmarrës në nderim të tyre. Rrezet e diellit futeshin në shpellë, paradite e pasdite, porse nuk binin direkt në ta.

Sa e sa e mira e Zotit u vjen vepërmirëve, edhe pse ata ndoshta nuk dinë gjë për to.

* Surja Kehf na mësoi çfarë të veprojmë që të qëndrojmë në rrugë të Zotit:

Të kapemi për Kurani: **“Dhe lexo atë që të është shpallur ty nga Libri i Zotit tënd!”** (Kehf, 27)

Të shoqërohemi me njerëz të mirë: **“Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe mbrëmje.”** (Kehf, 28)

Përshtatje

* Tek dialogu i dy personave rreth besimit në ringjallje, në suren Kehf, Allahu thotë:

“Pastaj hyri në kopshtin e vet dhe, duke qenë i padrejtë me vetveten, tha: “Unë nuk mendoj se kjo do të shkatërrohet ndonjëherë dhe nuk mendoj se do të arrijë ndonjëherë Kiameti. Por, edhe nëse do të më kthejnë te Zoti im, sigurisht që do të gjej një vend më të mirë se ky (kopsht)”! (Kehf, 35, 36)

“Shoku i tij i tha, duke biseduar me të: “A e mohon ti Atë, i Cili të ka krijuar nga dheu, pastaj nga pika e farës dhe të bëri më në fund njeri të plotë?!” (Kehf, 37)

Kur ta dëgjojmë dikë duke mohuar Zotin apo mësimet bazë të fesë

Islame, nuk duhet lënë pa e këshilluar, pa biseduar dhe pa i sjellë argumente atij.

Përshatje

* Në suren Kehf, gjatë dialogut, besimtari i tha mohuesit që mburrej me pasuri:

“Dije, Zoti im, mund të më japë diçka më të mirë se kopshti yt, ndërsa në kopshtin tënd mund të dërgojë një shkatërrim nga qielli e të gdhijë rrafsh pa asgjë.” (Kehf, 40)

Dhe ashtu ndodhi: **“Dhe pasuria e tij (e mohuesit) u shkatërrua.”** (Kehf, 42)

Kujdes nga fjalët që i thotë i devotshmi, ngase ai flet me dritë të besimit dhe gjërat i lexon përmes ligjeve të Zotit.

Përshatje

* Në suren Kehf, përshkruhet një nga çastet e frikshme të Ditës së Kiametit:

“Ata do të sillen të radhitur para Zotit tënd (e do t’u thuhet): “Tashmë Na erdhët, ashtu siç ju krijuam herën e parë.” (Kehf, 48)

Pamje shumë e frikshme! Duke qëndruar në rresht, pret kah do të nisesesh.

Përshatje

* Në suren Kehf përshkruhet rrugëtimi i Musait ﷺ me shoqëruesin, për tek Hidri ﷺ:

“Kur kaluan më tej, Musai i tha shoqëruesit të vet: “Na jep drekën tonë, sepse jemi lodhur nga ky udhëtimi ynë.” (Kehf, 62)

Për Allahun ishte shumë e lehtë t’i takonte Musain dhe Hidrin; ashtu që Musai as të mos shpenzonte mund dhe as të mos merrte udhë, porse po na tregon se rruga e dijes është plotë lodhje dhe sakrificë.

Përshtatje

* Allahu ia zgjodhi Musait ﷺ një mësues të cilin e lavdëroi: **“Dhe gjetën një rob prej robërve Tanë, të cilit i kemi dhuruar mëshirën Tonë dhe e kemi mësuar nga ana Jonë me dijeni të plotë.” (Kehf, 65)**

Shikoni si e përmendi mëshirën para diturisë, për të treguar se prej cilësive më të zgjedhura të mësuesit është mëshira. Kjo ngase mësuesi i mëshirshëm është më i dobishëm dhe më lehtë merret mësimi prej tij.

Përkthim

* Gjatë tregimit të Musait ﷺ me Hidrin, ndalu tek ajeti:

“Dhe kështu, u nisën. Kur hipën në një anije, ai (Hidri) hapi një vrimë poshtë. (Musai) tha: “Mos vallë, e hape vrimën për t’i

mbytur udhëtarët e saj? Me të vërtetë, ke bërë punë të shumë të keqe.” (Kehf, 71)

Shikoje mirë këtë pjesë: **“për t’i mbytur udhëtarët e saj.”**

Musai ﷺ ishte në anije, por nuk tha se do më mbytësh mua. Kështu janë përmirësuesit; brengën e kanë për të tjerët, madje para vetes së tyre.

Përshatje

* Gjatë tregimit të Musait ﷺ me Hidrin, ndodhi edhe kjo:

“Dhe që të dy vazhduan të ecin, derisa arritën në një fshat dhe u kërkuan banorëve të tij, që t’u jepnin për të ngrënë, por ata nuk i pranuan mysafirë.” (Kehf, 77)

Musai dhe Hidri ishin njerëzit më të mirë të asaj kohe, megjithatë banorët e fshatit nuk i nderuan; as bukë nuk iu dhanë.

Mos u mërzitë nëse njerëzit nuk ta dinë vlerën!

Përshatje

* Gjatë udhëtimit të Musait ﷺ me Hidrin, ndodhi që Hidri ta drejtojë një mur, i cili gati sa nuk ishte rrënuar:

“E sa i përket murit, ai ishte i dy djelmoshave jetimë të atij qyteti,

e nën të ata kishin një thesar.” (Kehf, 82)

Jetimët e humbën babanë, por nuk e humbën Zotin. E sheh se si Zoti ua dërgoi Hidrin për mur të tyre.

Përktim

* Allahu i Madhëruar në suren Kehf e përmend tregimin e djelmoshave të cilët qëndruar besnikërisht në fe.

Nuk i përmendi me emra, mirëpo i përjetësoi veprat e tyre, ngase vlera e njeriut është në veprat e tij, e assesi nuk është në emrin, pamjen apo prejardhjen e tij.

Përktim

* Xheneti Firdeus është përmendur në Kuran vetëm dy herë; në suren Kehf dhe Muminun. Në të dy vendet, përmendja e Firdeusit ka ardhur pas përmendjes së besimit, veprave të mira, ambicies së lartë në adhurim, sakrificës, të ndihmuarit e fesë, qëndrueshmërisë në fe, ashtu siç është e potencuar në tregimin e banorëve të shpellës dhe të cilësive të besimtarëve.

Përktim

* Allahu i Madhëruar na i tregon fjalët e Zekerijasë ﷺ i cili tha: **“Zoti im! Vërtet, mua më janë dobësuar eshtrat, më janë përhapur thinjat në kokën time, e me lutjen time ndaj Teje o Zoti im, asnjëherë nuk kam qenë i dëshpëruar.”** (Merjem, 4)

Në pamje të jashtme, rrugët janë të mbyllura: eshtrat janë dobësuar, flokët janë thinjur, gruaja nuk lind. Që i bie se të gjitha sebepepet janë të mbyllura. Kështu që ato mund t’i hapë vetëm Ai që i krijoi. Prandaj Zekerija ﷺ tha: **“E me lutjen time ndaj Teje o Zoti im, asnjëherë nuk kam qenë i dëshpëruar.”**

Përshtatje

* Zekerija ﷺ e luti Allahun që t’i dhurojë fëmijë: **“Më dhuro nga ana Jote një pasardhës (një fëmijë).”** (Merjem, 5) Zekerija ﷺ pasi e pa mrekullinë e Allahut tha: **“O Zoti im, prej nga mua djalë, kur gruaja ime ishte që nuk lind, e unë kam arritur pleqëri të thellë?”** (Merjem, 8)

Disa dhurata hyjnore aq shumë të befasojnë saqë të bëjnë të harrosh se ti je lutur për to.

Përktim

* Kur Allahu e përgëzoi Zekerijanë ﷺ me djalë, ai u çuditë, porse Allahu iu drejtua: **“Tha: Ashtu, ka thënë Zoti yt: Kjo për Mua është lehtë.”** (Merjem, 9)

Porosi për çdo të sëmurë: Edhe kur të dorëzohen mjekët dhe thonë se është vështirë, kujtoje se për Zotin e mjekëve është e lehtë. Gjatë lutjes sate thuaj: O Zot, kërkesa ime për Ty është e lehtë!

Përktim

* Allahu i Madhëruar na tregon për modelin që duhet ta ndjekim:

“Dhe, përmende në këtë Libër, Ismailin! Me të vërtetë, ai e plotësonte premtimin e dhënë.” (Merjem, 54)

Për Jahjanë ﷺ thotë: **“Edhe i sjellshëm ndaj prindërve të vet, e nuk ishte kryelartë e i padëgjueshëm.”** (Merjem, 14)

Për ensarët thotë: **“Ata u japin përparësi atyre (muhaxhirëve), edhe pse vet ishin nevojtarë për këtë.”** (Hashër, 9)

Për sjelljen që duhet ta kemi me njerëzit thotë:

“Dhe bëhuni të drejtë sepse Allahu i do të drejtët.” (Huxhurat, 9)

“O ju që keni besuar! Mos ta përqesh një popull, një popull tjetër.” (Huxhurat, 11)

“Mos i hulumtoni të metat (e njëri-tjetrit) dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin!” (Huxhurat, 12)

Prandaj, Indonezia e pranoi Islamin përmes tregtarëve musliman, jo se ata e njihnin mirë gjuhën e popullit indonezian, mirëpo këta tregtarë e njihnin mirë gjuhën e edukatës Islame.

* Allahu na tregon se çfarë bëri Merjemja, para se të lindte: **“E, dhembjet e lindjes, e detyruan atë që të vijë te trangu i një hurme.”**
(Merjem, 23)

Nëse dikë e shtynë nevoja të vijë tek ti, shkundi prej të mirave që t'i ka dhënë Allahu, e mos e kthe duarthatë. Mos lejo që pema e hurmës të jetë më e mirë se ti.

Përktim

* Kur Allahu ia dha mrekullinë Merjemes, ajo tha: **“Ah sikur të kisha vdekur para kësaj (ngjarje) dhe të isha harruar krejtësisht.”**
(Merjem, 23)

Grua shumë e dalluar, megjithatë e tha këtë! Mos qorto për fjalët që thuhën në momente të rënda!

Përktim

* Prej rregullave të mëdha që kanë të bëjnë me ruajtjen e nderit e të moralit, ashtu që shtëpia të jetë e ndershme, është përmirësimi i babës dhe i nënës, para së gjithash. Prindi duhet të jetë shëmbëlltyrë për fëmijën e tij. Rrënjët duhet të jenë të pastra, ashtu që edhe fryti të jetë i pastër, me lejen e Allahut.

Kjo gjë dihet edhe te popujt e mëhershëm. Shiko çfarë i thanë benu israilët Merjemes:

“Oj motra e Harunit, babai yt nuk ishte njeri i prishur e as nëna jote nuk ka qenë e pamoralshme.” (Merjem, 28)

Pra, ata u çuditën: si ti veprime kështu (mbete me barrë), ndërkohë as babai e as nëna jote nuk kanë qenë të pamoralshëm!

Sikur po i thonë: Prej nga ti kështu?!

Dihet se ajo ishte e pastër, porse ata reagues nga natyrshmëria e pastër që kishin.

Së këndejmi, themi se ne duhet të jemi të kujdesshëm, që të jemi shëmbëlltë për fëmijët tanë. Madje, jo vetëm në çështje që janë të drejtpërdrejta me moralin, por edhe në rrugët që çojnë në prishje të moralit, siç janë fotot apo filmat e pistë.

* Për të gjithë ne që ankohemi e nuk punojmë, po i kujtoj këta shembuj:

E kujtoj Isain ﷺ i cili thotë: **“Më bëri të bereqetshëm kudo që të jem.”** (Merjem, 31), i bereqetshëm kudo, në vendlindje apo në kurbet, në xhami apo në shtëpi, në punë apo në ndejë; madje në çfarëdo rrethane, i sëmure apo i shëndosh, i varfër apo i pasur.

Me siguri se asnjëri nuk jemi të sprovuar siç ishte Isai ﷺ, iu mbytën shumë prej ndihmëtarëve, madje edhe ai ishte në shënjestër për t'u vrarë, por që Allahu e ngriti. Andaj rrethanat në të cilat jemi, nuk janë arsye të mos jemi të bereqetshëm.

Shikoje Ibn Tejmijen (Allahu e mëshiroftë!) çfarë thoshte: Nëse më vrasin, do jem dëshmor, nëse më dëbojnë, do të bëj turizëm, nëse më burgosin, do të vetmohem me Allahun. Kështu është puna ime, ngase Xhenetin e kam në gjoksin tim.

* Shikojeni Ibrahimin ﷺ! Allahu na e përmendi dialogun që kishte me babanë e tij. Ibrahim i ﷺ në disa ajete, sa herë që i foli babait, iu drejtua me fjalët:

“O babai im,” “o babai im,” “o babai im.” (Merjem, 42, 44, 45)

Azeri, babai i Ibrahimit ﷺ, ishte idhujtar dhe gjuha të cilën e përdori karshi Ibrahimit ﷺ ishte shumë e vrazhdë:

“Nëse nuk ndalesh, do të të gurëzohj!” (Merjem, 46)

Edhe pas kësaj gjuhe, Ibrahim i ﷺ nuk ia ktheu me të keqe, por u soll mirë me të:

“Ibrahimi i tha: “Selami (paqja) qoftë mbi ty!” (Merjem, 47)

Krejt kjo sjellje e mirë e Ibrahimit ﷺ, i tërë ky respekt ndaj babait, edhe pse ai nuk iu bind, nuk i shkoi dëm. Allahu e shpërbleu me fëmijë të mirë, me Ismailin ﷺ, i cili do ta respektojë babanë e vet, Ibrahimin ﷺ.

E dini se çfarë i tha Ismaili Ibrahimit, kur Allahu e urdhëroi Ibrahimin, që ta therë atë?! Ismaili tha: **“O baba, vepro çfarë je urdhëruar!”** (Safat, 102)

Momenti ishte shumë i vështirë: Ibrahim i me thikë në dorë, i duhej ta bënte kurban djalin, loçkën e zemrës, por, megjithatë, Ismaili iu nënshtrua, nuk ia prishi, madje me këtë gjuhë të butë i tha: **“O baba!”**

Kështu, sjellja e mirë e Ibrahimit me babanë e vet, iu kthye me sjellje të mirë nga i biri.

* Prej gjërave që e dallonte Ismailin ﷺ ishte se ai: **“E urdhëronte familjen e vet me namaz dhe me zekat.”** (Merjem, 55)

Të bësh dialog, është shumë e rëndësishme në gatimin e mirëfilltë të familjes, por nëse nuk mjafton dialogu, duhet edhe të urdhërohen.

Përshtatje

* Allahu i Madhëruar duke folur për Xhehenemin, na e tregon gjendjen e njerëzve: **“Secili prej juve do t’i paraqitet (afrohet) atij (Xhehenemit).”** (Merjem, 71)

Çfarë do të thotë se njerëzit do t’i paraqiten apo do t’i afrohen zjarrit, dijetarët kanë dhënë disa mendime:

1. Të gjithë njerëzit do të hyjnë në Xhehenem, mirëpo zjarri nuk do t’i lëndojë besimtarët.
2. Kalimi mbi Urën e Siratit, sepse ajo është e vendosur mbi xhehenem.
3. Do të jenë afër xhehenemit dhe do ta vëzhgojnë atë.

Përkthim

* **“Ne do ta shënojmë atë që flet.”** (Merjem, 79)

Kujdes çfarë po flet!

“Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar.” (Kehf, 49)

Kujdes çfarë po vepron!

Përshtatje

* Në suren Taha, përmendet rrëfimi i Musait ﷺ :

“Kur e pa zjarrin ai i tha familjes së vet: “Rrini ju këtu! Unë, me të vërtetë, e kam parë një zjarr; shpresoj se unë do t’ju sjell juve një gacë, ose që pranë tij do të gjej ndonjë udhërrëfyes.” (Taha, 10)

Musai ﷺ e kuptoi se familjen e tij e ka kapluar të ftohtit gjatë rrugës, për këtë edhe u nis që t’ua sigurojë ngrohjen. Mu këtë veprim të tij, Kurani e bëri të përjetshëm.

Po ne, a kemi hise në projekte të tilla!?

Përshtatje

* **“Ata thanë: O Musa, do të hedhësh ti apo ne po hedhim të parët? Ai (Musai) tha: Jo, hidhni ju! Kur, ja, atij iu duk se nga ajo magji e tyre litarët dhe shkopinjtë lëviznin (si gjarpërinj).”** (Taha, 65)

I dha përparësi “dëgjimit” të argumenteve të dobëta të kundërshtarit, ngase ai pas kësaj do të sjellë argumente të fuqishme me të cilat do ta rrënoj kundërshtarin në tërësi dhe nuk do të lë asnjë dyshim tek të pranishmit.

Përktim

* **“Andaj, pyetni njerëzit e dijshtëm nëse ju nuk dini!”** (Enbija, 7)

Të mos dish nuk është turp, por turp është të mbetesh i padijshtëm.

Përshtatje

* Disa njerëz, Caktimin e Allahut e shikojnë me llogari të gabuar; Çdo begati për ta është shenjë e mirë, kurse çdo sprovë për ta është shenjë e keqe.

Në realitet, edhe mira edhe e keqja janë provim për ne.

Allahu thotë: **“Ne ju vëmë në provë me të keqe dhe me të mirë.”**
(Enbija, 35)

Përshtatje

* Kur dikush nga ne, dëshiron ta lavdëroj dikë, sigurisht se do të shprehet: “Unë e njoh mirë atë.” Por ka të atillë, që Allahu ka thënë

për ta se i njeh mirë: **“Ne qysh më herët Ibrahimit i kemi dhënë urtësi dhe e kemi njohur shumë mirë.”** (Enbija, 51)

A ke parë lavdërim sikur ky?!

Përktim

* **“(Kujtoje) Dhun-Nunin (Junusin) kur iku i zemëruar e mendoj se Ne nuk do ta dënojmë, andaj thërriti nga errësira: “S’ka të adhuruar të denjë, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!” Ne iu përgjigjëm atij dhe e shpëtuam nga brengosja. Kështu, Ne i shpëtojmë besimtarët.”** (Enbija, 87,88)

Me këtë lutje: **“S’ka të adhuruar të denjë, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!”** Junusi ﷺ shprehu: Çiltërsinë e besimit, lavdërimin e Zotit, si dhe pranimin e mëkatit.

Prandaj i erdhi shpëtimi dhe ndihma në një vend ku shpresat për të shpëtuar ishin zero.

Përshatje

*Në suren Enbija përmenden lutjet e disa Pejgamberëve;

Nuhu ﷺ u lut, kurse Allahu tha: **“Ne iu përgjigjëm atij”** (Enbija, 76)

Ejubi ﷺ u lut, kurse Allahu tha: **“Ne iu përgjigjëm atij”** (Enbija, 84)

Junusi ﷺ u lut, kurse Allahu tha: **“Ne iu përgjigjëm atij”** (Enbija, 88)

Ejubi ﷺ u lut, kurse Allahu tha: **“Ne iu përgjigjëm atij”** (Enbija, 84)

Zekerija ﷺ u lut, kurse Allahu tha: **“Ne iu përgjigjëm atij”** (Enbija, 90)

Në fund përmendet se bepi i pranimit të lutjeve të tyre:

“Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe Na luteshin, me shpresë e frikë dhe ishin të përlulur ndaj Nesh.” (Enbija, 90)

Përshtatje

* Zekerija ﷺ kërkoi prej Allahut që ti jep pasardhës, po edhe përgjigjja ishte e menjëhershme: **“Ne iu përgjigjëm atij, ia dhuruam Jahjain dhe ia përmirësuaam gruan (e bëmë që të lind pasi ishte shterpë).”** (Enbija, 90)

Prej njeriut të mirë përfiton edhe rrethi, ngase për t’iu përgjigjur lutjes së Zekerijasë ﷺ është dashur të shërohet edhe gruaja e tij.

Përkthim

* **“(Kujtoje) atë që e ruajti nderin e saj.”** (Enbija, 91)

Merjemja nëna e Isait ﷺ ishte grua e devotshme dhe jeta e saj ishte në adhurim; në namaz e agjërim. Megjithatë, Allahu po e lavdëron

me faktin se ishte e ndershme.

Përshtatje

* **“O njerëz, ruajuni (dënimet të) Zotit tuaj! Me të vërtetë, dridhja e Ditës së Kiametit, është ngjarje e madhe!”** (Haxh, 1)

Në fillim të sures Haxh, përmendet Kiameti, ngase Haxhi nga pamja e jashtme (të gjithë të tubuar me një vend) i ngjason Ditës së Kiametit.

Përktim

* **“Ka njerëz që e adhurojnë Allahun luhatshëm (sikur dikush që rri në skaj të një objekti, pa u futur brenda).”** (Haxh, 11)

Për të qenë adhurimi apo ibadeti i qëndrueshëm, kërkohet që të futemi brenda thellë, përndryshe nëse qëndrojmë sipërfaqësisht, adhurimi do të jetë i luhatur.

Përshtatje

* **“Me të vërtetë, shpëtuan besimtarët, të cilët, në namazin e tyre janë të përlulur.”** (Muminun, 1,2)

T’i falësh dy rekate me zemër të përkushtuar është më mirë, sesa të falesh tërë natën, me zemër të preokupuar me diç tjetër.

Përshtatje

* Dr. Halid Sebti duke folur rreth rëndësisë së fjalëve të mira si dhe kujdesin që duhet ta kemi karshi fjalëve të pista, të vrazhda e të kota, thotë: Largimi prej fjalëve të kota është prej shtyllave të shpëtimit dhe mu për këtë Allahu e ka përmendur mes dy shtyllave të Islamit: namazit dhe zekatit:

“Me të vërtetë kanë shpëtuar besimtarët,” (Muminun, 1)

“të cilët janë të përrulur gjatë faljes së namazit,” (Muminun, 2)

“të cilët i shmangen të kotës (fjalë a punë),” (Muminun, 3)

“dhe të cilët rregullisht e japin zekatin.” (Muminun, 4)

E përmendi mes dy shtyllave për të treguar se duhet të kemi kujdes për fjalët që i flasim.

Përshatje

* Allahu i Madhëruar ia la një porosi të shkurtër Nuhut ﷺ: **“Dhe kur të vendosesh në anije ti dhe ata që janë me ty, thuaj: “Falënderimi i takon Allahut.”** (Muminun, 28)

Për ta shpëtuar Nuhun ﷺ dhe besimtarët, Allahu e mbushi tokën me ujë, ndërkaq prej tij kërkoi vetëm këtë: **“Thuaj: Falënderimi i takon Allahut.”**

Përkthim

* **“Juve u preokupoi shumimi. Derisa të mos i vizitoni varrezat.”**
(Tekathur, 1, 2)

Nëse jeta e varrezave e cila zgjatë me mijëra vite quhet vetëm si “vizitë,” atëherë si ta quajmë jetën e kësaj bote, që është disa vite?! shiko: **“Ata thanë: Qëndruam një ditë apo një pjesë të ditës.”** (Muminun, 113)

Përkthim

* Surja Nur: Ai që punon me të, e beson ata, thërret ne të, e lexon dhe e mëson atë; i bëhet dritë në zemër, në fytyrë e në jetë, në të kundërtën do ketë vetëm errësirë, sikur fytyrat e errëta të atyre që shpifin ndaj Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

Në këtë sure flitet për çështjen e nderit e të mbulesës, dhe kjo është dritë, ndërkaq e kundërta është errësirë.

O Allah na i mbush zemrat me dritë.

* **“O ju që keni besuar, nëse e keni frikë Allahun, Ai do t’ju jap juve furkan.”** (Furkan, 29)

Fjala “furkan” d.m.th. dallues i të vërtetës nga e kota, e mirës nga e keqja etj. Prej llojeve më të mira të “furkanit” që i jepet atij që e ka frikë Allahun është: Largpamësia në kohë të fitneve (sprovave).

Përkthim

* **“Dhe i Dërguari tha: “O Zot, populli im e braktisi Kuranin.”**
(Furkan, 30)

Edhe pse mëkatet e popullit ishin të llojlojshme, Pejgamberi ﷺ nga të gjitha këto mëkate, e zgjodhi t’i ankohet Allahut vetëm për Kuran.

Përkthim

* **“(faraoni) parisë që e rrethonte, u tha: Vërtet, ky qenka magjistar shumë i aftë! Që me magjinë e vet dëshiron t’ju dëbojë nga toka juaj, e ç’më propozoni mua?”** (Shuara, 34,35)

Edhe pse në momentin që i konsultoi parinë dhe e kërkoi mendimin e tyre, e demaskoi veten nga pretendimet se është zot, megjithatë nga ky rast kuptuam se çështjet e rëndësishme nuk duhet vendosur i vetëm, pa i konsultuar personat e besueshëm.

Edukatën e konsultës na e mësoi edhe mbretëresha e Sebesë, edhe pse akoma nuk ishte besimtare, ajo i tha parisë:

“O ju pari, më sugjeroni në çështjen time, se unë nuk do të vendosi asgjë derisa edhe ju të jepni pëlqimin!” (Neml, 32)

* Hud-hudi edhe pse ishte shpend i vogël, iu drejtua Sulejmanit ﷺ me këto fjalë: **“Kam marrë vesh atë që nuk e ke ditur ti dhe të kam sjellë lajm të sigurt prej Sebesë.”** (Neml, 22)

Prijës i suksesshëm është ai që ua lejon parisë, ta japin mendimin,

madje pa u frikësuar dhe pa u ngushtuar.

Përktim

* **“Në qytet kishin qenë nëntë vetë që bënin ngatërresa në Tokë e nuk vinin rregull.”** (Neml, 48)

Nuk po thotë: Bënin ngatërresa ‘në qytet’, por ‘në Tokë’, sepse dëmi i njerëzve që prishin dhe bëjnë ngatërresa, nuk përkufizohet vetëm brenda qytetit, por edhe më gjerë.

Madje të keqen e tyre e përjeton edhe bota bimore e shtazore.

Përshatje

* Pasi Musain ﷺ e gjetën në lumë brenda kutisë, gruaja e faraonit iu drejtua atij me këto fjalë: **“Kënaqësi e syrit për mua dhe për ty, mos e vrani atë.”** (Kasas, 9)

Faraoni e theu ‘urdhrin në fuqi’ me të cilin duhej vlarë çdo fëmijë i porsalindur, e dëgjoji gruan dhe nuk e vrau Musain.

Gruaja është personi që më së shumti ndikon tek burri, andaj ajo është rast i mirë për përmirësimin e burrit. Aq më parë kur burri ka emër dhe pushtet.

Përktim

* Musai ﷺ posa u dha ujë bagëtive të atyre dy vashave, me atë rast:
“Njëra prej tyre erdhi tek ai, dhe teksa po ecte i vinte turp e i tha.”
(Kasas, 25)

Turpi nuk është vetëm në veshje e në të folur, por edhe në të ecur.

Përktim

* Surja Rrum edhe pse e shkurtër, flet për të dhëna të ndryshme;

Historike, ku flet për betejën mes Bizantit dhe Persisë.

Ekonomike, ku flet për vlerën e zekatit dhe dëmin e kamatës.

Shoqërore, ku flet për urtësi madhështore të martesës.

Përktim

* Ringjallja dhe Dita e Kiametit, janë tema madhështore të Kuranit. Një pjesë e madhe e sureve dhe ajeteve që flasin për to, na i sqarojnë ato në mënyra dhe me argumente të ndryshme, prej tyre:

“Ai është që e shpik jetën dhe pastaj e përsërit atë, e ajo (përsëritja) është edhe më e lehtë për Të.” (Rum, 27)

Allahu siç i krijoi njerëzit dhe krijesat tjera, për herë të parë, Ai i rikthen ato, ndërkaq në logjikën tonë me e rikthye një gjë, apo me e përsërit atë, është më e lehtë sesa shpikja apo krijimi i saj për herë të parë.

Dy raste në Kuran, ku përmenden fjalët e mohuesve të Kiametit dhe të ringjalljes, përgjigjja ka ardhur kështu: **“Thuaj: Po, betohem në Zotin tim.”** (Sebe,3). **“Thuaj: Po, betohem në Zotin tim, ju gjithsesi do të ringjalleni.”** (Tegabun, 7)

* **“Dhe çka të jepni prej kamatës, që të shtohet në pasurinë e njerëzve, ajo nuk shtohet tek Allahu, e çka të jepni nga zekati (sadakaja), duke kërkuar Fytyrën e Allahut, të tillët janë ata që u shumëfishohet (shpërblimi).”** (Rrum, 39)

Sa herë që kanë ardhur ajetet e kamatës, para ose pas tyre janë përmendur sadakaja apo zekati, sepse “fitimi” i vërtetë është në to, e jo në kamatë.

Përkthim

* Prej metodologjive edukative në këshillat e Llukmanit drejtuar të birit është se ai ia sqaroi të birit shkakun e urdhrit: Llukmani tha: **“O djali im, mos i bëj shirk Allahut.”** (Llukman, 13), pastaj ia sqaroi shkakun: **“Sepse shirku është padrejtësi e madhe.”** (Llukman, 13)

Përshtatje

* Ndalim te këto ajete:

“Askush nuk e di se çfarë do të fitojë nesër dhe askush nuk e di se

ç'vend do të vdes.” (Llukman, 34)

Musai ﷺ tha: **“Me mua është Zoti im, Ai më udhëzon.”** (Shuara, 62)

Hudi ﷺ tha: **“Të gjithë ju bëni komplot kundër meje dhe mos më jepni afat aspak.”** (Hud, 55,56)

Dhe rrënoji konspiracionet me to!

* **“Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët.”** (Lukman, 19)

Kurani na e mësoi edukatën dhe moralin, deri në atë masë, saqë na i mësoi detajet e ecjes dhe nivelin e zërit.

Përshtatje

* **“Dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme.”** (Lukman, 20)

Transmetohet nga Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) të ketë thënë: Dhuntitë e dukshme të Allahut janë Islami dhe Kurani, kurse dhuntitë e padukshme janë mbulimi i mëkateve dhe mos nxitimi me ndëshkim.

Përshtatje

* Surja Llukman na i mëson veçoritë e personalitetit të besimtarit:

Mos i bëj shoq Allahut.

Respektimi i prindërve.

Duhet ta ketë në mendje se Allahu gjithmonë e përcjellë.

Ta falë namazin.

Të urdhëroj në të mirën dhe të ndaloj nga e keqja.

Të jetë modest e jo mendjemadh.

Ta ulë zërin kur të flet me të tjerët.

Përkthim

* **“Ne do t’u shijojmë atyre dënimin më të shpejtë (në dynja) para dënimit të madh (në Ahiret), ndoshta do të tërhiqen (prej të këqijave).”** (Sexhde, 21)

Disa nga dënimet e shpejta (në dynja) janë mesazhe përkujtuese për të shkujdesurit, ndoshta pendohen.

Përkthim

* Ajeti: **“Vërtet Allahu dhe melekët e Tij bëjnë «salavate» për të Dërguarin.”** (Ahzab,)

Shikoni fjalën “melekët,” është në shumës, pra të gjithë melekët, e që

janë numër shumë i madh, lutën apo bëjnë salavate për Muhamedin



Melekët e njohën mirë andaj e nderuan shumë.

Në të kundërtën: Ata që u munduan ta përçmojnë, sikur Ebu Xhehli me shokë, të cilët ia hedhën zorrët e devesë mbi kokë, derisa ishte në namaz, e kur e mbaroi namazin u ngrit dhe u lut kundër tyre, madje një nga një i përmendi me emra. Abdullah ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: Të gjithë ata i kam parë të mbytur në Bedër.

* **“E atij që vepra e vet e keqe, i është hijeshuar dhe i duket e mirë ajo.”** (Fatir, 8)

Njeriu është afër pendimit, përderisa gjynahun që e bënë e sheh se është mëkat.

Ndërkaq nëse veprën e vet të keqe, e sheh se është e mirë, le ta dijë se e ka zgjedhur lajthitjen.

Përshtatje

* Allahu i Madhëruar në suren Jasin na e rrëfeu tregimin e një vendbanimi, ku i dërgoi tre pejgamberë. Meqë populli i këtij vendbanimi nuk besuan, atëherë thirrjes së Pejgamberëve iu bashkëngjit edhe një burrë:

“Prej skajit të qytetit erdhi një burrë duke shpejtuar dhe tha: “O

populli im, pasoni pejgamberët.” (Jasin, 20).

Shiko: Prania e pejgamberëve nuk e ndali prej thirrjes. Nuk e shikoi largësinë, por nxitoi në punë të mira dhe njerëzit i trajtoi me butësi.

* Në kontekstin e numërimit të begative të banorëve të Xhenetit dhe shpëtimit të tyre prej Zjarrit, Allahu iu drejtohet besimtarëve me këtë ajet madhështor: **“Për një shpërblim të këtyllë le të vepronjë vepruesit!”** (Safat, 61).

Abdurrahman Sadi thotë: “Kjo është gjëja më meritorë për të cilën mund të shpenzohen frymëmarrjet e frymëmarrësve dhe të përvilen për të, të mençurit e ditur. A ka humbje më të madhe për të zellshmin, sesa ti ikën koha, ndërkaq ai nuk është i zënë me vepra (të mira) të cilat e afrojnë tek ky vendbanim (Xheneti). E si qëndron puna e atij që ecën me mëkate, drejtë vendbanimi të Zjarrit?!”

* Prej Pejgamberëve më të dalluar ishte Ibrahim عليه السلام. Allahu i Madhëruar për të, thotë: **“Kur Zotit të vet i erdhi me zemër të pastër.”** (Safat, 84)

Ibrahimi عليه السلام ia shkurtoi rrugën vetit; u koncentrua në zemër dhe kështu arriti më shpejt tek Allahu.

Përktim

* Allahu i Madhëruar në suren Safat i ka përmendur shkaqet e shkatërrimit të disa popujve: Përqeshja me argumentet e Allahut.

Mos pranimi i këshillës, pretendimi se Mesazhi Hyjnor është i kotë, përgënjeshtrimi i ringjalljes, mendjemadhësia, cilësimi i Pejgamberit ﷺ si i çmendur apo si poet, pasimi i verbër i baballarëve.

Përktim

* Në fillim të sures Sad, kemi tregimin e dy personave të cilët shkuan tek Davudi ﷺ për tu gjykuar mes vete. Në mes tjerash, Allahu i Madhëruar na i përshkruan fjalët e njërit prej tyre: **“Ky, vëllai im.”** (Sad, 23)

Shiko, edhe pse kanë mosmarrëveshje dhe kanë ardhur për tu gjykuar, prapë mbesin lidhjet dhe mbetet dashuria vëllazërore.

Hakun tënd ke të drejtë ta kërkosh, por jo t’i shkëputësh lidhjet dhe të armiqësohesh me të.

Përktim

* Allahu i dha Sulejmanit ﷺ pushtet dhe pasuri, megjithatë ai ishte: **“Rob shumë i mirë dhe shumë i kthyer nga Zoti.”** (Sad, 30)

Allahu e sprovoi Ejubin ﷺ me varfri dhe me sëmundje, megjithatë ai ishte: **“Rob shumë i mirë dhe shumë i kthyer nga Zoti.”** (Sad, 44)

Dy gjendje krejt të kundërta; njëri në mirëqenie, e tjetri në provë, porse ata kishin një qëllim: me qenë rob të mirë dhe të kthyer nga Allahu.

Përshtatje

* **“E ata që nuk besuan sillen në grupe te Xhehenemi, e kur arrijnë te ai, dyert e tij hapen.”** (Zumer, 71)

“E ata që ishin të devotshëm ndaj Zotit të tyre, sillen në grupe te Xheneti, e kur arrijnë aty, dyert e tij i gjejnë të hapura.” (Zumer, 73)

Banorët e zjarrit, kur të arrijnë te Xhehenemi, dyert i gjejnë të mbyllura, e pastaj ato papritmas hapen pranë syve të tyre, për ta shijuar trishtimin e tij.

Kurse banorët e Xhenetit, kur të arrijnë te Xheneti, dyert e tij i gjejnë të hapura, si nderim për ta, ashtu siç është zakon të priten të ndershmit.

Tahir ibn Ashuri

* **“Do t’i shohësh melekët të tubuar rreth Arshit (Fronit).”** (Zumer,75)

Në lidhje me këtë ajet, Ibn Kethiri në librin “el-Bidaje ven-nihaje” na e tregon një gjë të bukur: Pasi u shtua numri i muslimanëve, pas përhapjes së Islamit, u shfaq një problem në lidhje me safat e namazit pas imamit në Qabe, vetëm në një drejtim.

Atëherë, Allahu i Madhëruar e udhëzoi një person i cili quhej Halid Kasri, të argumentojë me ajetin e lartpërmendur dhe me këtë rast njerëzit filluan të falen përreth Qabesë, në të gjitha anët e saj, pas një imami të vetëm.

Përkthim

* **“Praktikojeni fenë e drejtë e mos u përçani në të.”** (Shura, 13)

Allahu i Madhëruar i dërgoi Pejgamberët që ta praktikojnë fenë dhe t'i largohen përçarjes.

Përkthim

* Është një rregull madhështor: Shpërblimi apo ndëshkimi vjen sipas llojit të veprës. Shembuj për shpërblimin: Kush jep, Allahu i jep atij. Kush i ndihmon vëllait të vet, Allahu i ndihmon atij. Shembull për ndëshkimin: Faraoni mburrej me këto fjalë: **“Dhe këta lumenj rrjedhin nën mua. A nuk shikoni ju?!”** (Zuhruf, 51) Kështu u ndëshkua me atë që mburrej.

* **“Vërtet, ata që të thërrasin ty (o Muhamed) me zë të lartë nga jashtë dhomave të tua, shumica e tyre nuk marrin vesh.”** (Huxhurat, 4)

Ky ajet ka zbritur rreth disa beduinëve, të cilët kur erdhën në Medinë e thirrën Pejgamberin ﷺ me zë të lartë. Për këtë Kurani i qortoi se të tillët nuk marrin vesh e nuk kuptojnë.

Sigurisht se edukata e personit tregon për mendjen që ka.

Përshtatje

* **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre.”** (Huxhurat, 10)

Mos rri duar lidhur, thuaj ndonjë fjalë apo vepro diçka për t'i afruar e pajtuar ata që janë hidhëruar mes vete.

Përshatje

* Nëntë porosi nga kaptina Huxhurat, si të sillemi me njerëzit:

“Sigurohuni mirë,” kur t'ju vjen ndonjë lajm.

“Pajtojini,” besimtarët mes veti.

“Mbani drejtësi,” mes tyre.

“Mos e përqeshni,” dikë tjetër.

“Mos e nënçmoni.”

“Mos etiketoni me nofka.”

“Largoni shumë paragjykime.”

“Mos spiunoni.”

“Mos përgojoni.”

Përkthim

* Allahu i Madhëruar në shumë ajete na flet për vëllazërinë: **“Dhe ashtu me dhuntitë e Tij u bëtë vëllezër.”** (Ali Imran, 103). **“Me të vërtetë besimtarët janë vëllezër.”** (Huxhurat, 10)

Sigurisht se lëndimi dhe shqetësimi i besimtarit është gjë e shëmtuar. Prej shembujve konkret që mund të ndodhë lëndimi i besimtarit është: Kur i pasuri ia jap të varfrit zekatin dhe i thotë: Merre këtë zekat.

Hasen Basriu thoshte: Mos i trego se është zekat! A dëshiron ta shtypësh atë? Ahmed ibn Hanbelin kur e pyetën se a duhet t’i tregoj se është zekat, ai tha: Përse ta lëndoj me këto fjalë?! Ia jep dhe nuk i tregon. Nuk ka nevojë që ta shqetësoj atë.

* Allahu i Madhëruar na e përshkruan anijen e Nuhut ﷺ me të cilën shpëtoi:

“E atë (Nuhun) e bartëm në (anije) dërrasash me gozhda.” (Kamer, 13)

Po çfarë mund të bëjnë dërrasat e gozhduara, për ta mbrojtur Nuhun ﷺ me gjithë ato krijesa që ishin brenda saj, nga ai ujë i madh që vërshoi çdo gjë?

Ishte vetëm se ajo anije: **“Lundronte nën vështrimin Tonë,”** Zotit Fuqiplotë.

Përktim

* Në suren Hadid, nxitja për të dhënë lëmoshë ka ardhur në shumë

ajete, në formë direkte apo indirekte:

“Besoni në Allahun e në të Dërguarin e Tij dhe jepni.” (Hadid, 7)

“Çka keni që nuk jepni.” (Hadid, 10)

“E kush prej juve i jep borxh Allahut.” (Hadid, 11)

“Ata që japin dhe ato që japin.” (Hadid, 18)

Pastaj e hasim qortimin e koprracëve: **“Ata që janë koprrac dhe që urdhërojnë njerëzit në koprraci.”** (Hadid, 24)

Në mes të këtyre ajeteve ka ardhur qortimi i atyre që kanë zemra të ngurta.

Kjo aludon se lëmosha e shëron dhe e zbut zemrën.

Përkthim

* Allahu i Madhëruar thotë: **“O besimtarë! Kur ju thuhet t’u hapni vend të tjerëve në tubim, atëherë bëni vend, se Allahu do t’ju bëjë vend juve (në Xhenet).”** (Muxhadile, 11)

Nëse me kaq “t’u hapim vend të tjerëve në tubim” na shtohet furnizimi në dynja dhe na zgjerohet vendi në Xhenet, edhe pse lëvizja për të hapur vend (në ndejë) nuk e dëmton fare personin, e as që e lodhë atë.

E si do të jetë puna e atij që ia largon një brengë besimtarit, apo ia shuan urinë, apo ia kryen një punë.

Dr. Salih Behlal

* **“Kur Musai i tha popullit të vet: O populli im, përse po më mundoni, kur mirë e dini se unë jam Profeti i Allahut te ju!”** (Saf, 5)

Mundimi është edhe më i madh, kur bëhet prej personit që e di se ti je në të vërtetën.

Përkthim

* **“Thuaj: “S’ka dyshim se vdekja prej së cilës po ikni, ka për t’ju takuar.”** (Xhumua, 8)

Ikja nga dikush bëhet duke e lënë mbrapa atë dhe duke u larguar prej tij, porse te vdekja, shprehja kuranore po na tregon se vdekjes nuk i iket, sepse sado që të ikësh, ajo do t’ju pret e do t’ju takojë, ngase vdekjen e keni para, ju nuk ikni prej saj, por realisht ikni kah ajo.

Përshtatje

* **“O besimtarë, kur të thirreni për lutje ditën e premtë, nxitoni për ta përmendur Allahun (namazi i xhumasë) dhe pezulloni shitblerjen; kjo është më mirë për ju, nëse e dini!”** (Xhumua, 9)

Fjala ‘nxitoni’ nuk do të thotë të ngutemi e të shkojmë me vrap, por do të thotë që t’i kushtojmë rëndësi të madhe, të shkojmë më herët, të jetë brenga më e madhe e jona atë ditë, e mos ta anashkalojmë.

Përshtatje

* **“E kur të përfundojë namazi (i Xhumasë), atëherë shpërndahuni nëpër tokë dhe kërkoni nga begatitë e Allahut.”** (Xhumua, 10)

Brenda xhamisë kërkohet Mëshirën e Allahut, kurse jashtë xhamisë kërkohet të mirat e Tij.

Përktim

* Surja Munafikun:

Shpalos disa cilësi të hipokritëve: Gënjejnë, janë frikacakë, betohen rrejshëm, i urrejnë besimtarët, kanë mendjemadhësi.

Përveç kësaj, Allahu na e tërheq vërejtjen prej cilësive të hipokritëve në më shumë se 300 ajete.

Ibn Kajimi ka thënë: Kurani gati sa nuk zbriti i tëri në lidhje me hipokritët. *Përktim*

* **“O besimtarë, mos t’ju habitin pasuria dhe fëmijët tuaj nga të përmendurit e Allahut. E ata që bëjnë këtë, vërtetë ata kanë humbur.”** (Munafikun, 9)

Kushdo që nuk e përmend Allahun, me arsye se është i zënë me fitim të pasurisë, në realitet i tilli nuk është duke fituar, porse duke humbur. Allahu po thotë: **“E ata që bëjnë këtë, vërtetë ata kanë humbur.”**

Përshtatje

* Shikoni çfarë na thotë surja Tegabun dhe çfarë do të thotë fjala *tegabun*:

“Atë Ditë, kur Ai do t’ju tubojë juve në Ditën e Kiametit, ajo është Dita e Mashtrimit.” (Tegabun, 9)

Shumë njerëz mendojnë se posa të vdesin, do të përfundojë çdo gjë. Por në të vërtetë, kur të vdesin, do ta shohin vetveten pranë Allahut e të fillojë llogaria!

Njashtu, shumë njerëz mendojnë se çështja e ahiretit është shumë e lehtë, madje pretendojnë se janë prej banorëve të Xhenetit. Mirëpo, ja, kur të ringjallen, e shohin se me vete kanë shumë pak vepra të mira, ndërsa llogaria qenka e vështirë. Këta njerëz do të mashtrohen, sepse nuk u del ashtu siç kanë menduar.

* Në kaptinën Talak (Divorci) ajeti: **“E ai që e ka frikë Allahun,”** përmendet tri herë, e në këtë kemi disa porosi:

Frika nga Allahu është shkak i gjetjes së zgjidhjes.

Në raste të problemeve familjare duhet ta kemi frikë Zotin, e të mënjanohet parulla: “unë duhet të fitoj.”

Frika nga Zoti nuk na lejon të bëjmë padrejtësi.

Përshtatje

* **“O ju që keni besuar! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lëndë djegëse të të cilit janë njerëzit dhe gurët.”** (Tahrim, 6)

A ka më nënçmim për njeriun sesa të barazohet me gurët?! Kujdes mos e sjellë veten tënde në këtë shkallë, ndërkaq Allahu të ka nderuar me mendje të shëndoshë.

Përkthim

* **“Atyre që mohuan, Allahu u sjell shembull gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato të dyja ishin në kurorë të dy robërve të mirë nga robërit tanë, por ato të dyja i tradhtuan (në fe) ata të dy dhe këta të dy nuk mund t’i mbrojnë ato fare te Allahu. Atyre dyjave u thuhet: “Hyni në zjarr së bashku me ata që hyjnë!”** (Tahrim, 10)

Njeriun e mirë nuk e prishin veprat e këqija e të afërmit të tij, e as të keqin nuk e ndihmon fetaria apo burrëria e të afërmit të tij.

Është shumë humbje e madhe për njeriun, nëse atij i janë mundësuar shkaqet e udhëzimit dhe i bërjes së veprave të mira, porse ai i refuzon ato.

Përkthim

* **“E atyre që besuan, Allahu u solli shembull gruan e faraonit kur ajo tha: “Zoti im, më bën një vend pranë mëshirës Sate në Xhenet dhe më shpëto prej faraonit e brutalitetit të tij dhe më shpëto prej**

popullit mizor!” (Tahrim, 11)

Sakrificat nuk është e përkufizuar vetëm tek burrat. Kushdo që sakrifikon qoftë mashkull apo femër, kjo tregon për besimin e sinqertë dhe fuqinë e bindjes që ka ai apo ajo.

Përkthim

* Allahu i Lartësuar na tregon se Nuhu ﷺ tha: **“O Zoti im, unë e thirra popullin tim (në besim të pastër) natën e ditën.”** (Nuh, 5)

Thirrja në besim të pastër është mision i përhershëm, e nuk është etapë kohore që mbaron.

Përkthim

* Treshja e shpëtimit:

Shikoje treshen e shpëtimit sipas renditjes kohore që kanë zbritur:

Dija: **“Lexo në Emër të Zotit tënd!”** (Alak, 1)

Ibadeti apo adhurimi: **“Falu natën.”** (Muzemil, 2)

Daveti apo thirrja islame: **“Qohu e thirr (në Islam)!”** (Mudethir, 2)

Përkthim

* **“O ti, i mbuluar (o Muhamed)! Ngrihu dhe tërhiqu vërejtjen (duke i thirrur).”** (Mudethir, 1,2)

Edhe pse u mbulua që t'i ndalë ethet e frikës, Allahu nuk i dha hapësirë të qëndrojë ashtu, sepse daveti apo thirrja nuk bënë të vonohet.

Përshatje

* **“Dhe mos u mburr me atë që e bënë e të të duket shumë!”** (Mudethir, 6)

Mos i numëro veprat e mira dhe sukseset e tua, duke menduar se shumë ke bërë!

Allahu të zgjodhi e ta mundësoi të bësh vepra të mira dhe të arrish aty ku je.

Përshatje

* Prej virtyteve të besimtarëve fisnikë, Allahu përmend edhe këto:

“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët robër edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: “Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim!” (Insan, 8,9)

Ibn Tejmije ka thënë: Ai që kërkon prej të varfërve të luten për të (pasi u ka ndihmuar), e ka privuar veten nga ky ajet.

Këta besimtarë fisnikë, e kanë kuptuar se nevoja e tyre për shpërblim është më e madhe se nevoja e të varfërve për lëmshë.

Përshtatje

* Së pari përmendet bamirësia:

“(Ata thonë): “Ne, ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Ne, për këtë, nuk duam shpërblim as falënderim!” (Insan, 9)

Më pas vjen shpërblimi:

“Allahu i ruan ata nga tmerret e asaj Dite; Ai atyre u jep shkëlqim (në fytyrat e tyre) dhe gëzim.” (Insan, 11)

Po pra, ua larguan brengën e të varfëve, e cila vërehej në fytyrat e thyera të tyre, kështu që Allahu ua hijeshoi fytyrat e bamirësve në Ditën e Gjykimit.

Përshtatje

* Allahu i Madhëruar e përshkruan bukurinë e shërbëtorëve të Xhenetit të cilët janë djelmosha të përjetshëm: **“Kur ti shikosh ata, të duken se janë margaritar të shpërndarë.”** (Insan, 19)

E si do të jetë bukuria e atyre që u shërbehet.

Përkthim

* Abdullah ibn Umu Mektumi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ishte i

verbër dhe për të zbritën ajete kuranore:

“Ndërsa ai që nxiton dhe vjen te ti, ngase ai e ka frikë (Allahun).”
(Abese, 8,9)

Po ishte i verbër, porse shkoi me nxitim tek Pejgamberi ﷺ që të mësojë prej tij, madje kishte frikë se nuk po i kryen obligimet si duhet, për këtë edhe Allahu e lartësoi emrin dhe historinë e tij.

Pengesat nuk e ndalën që të afrohet tek Allahu.

Përshtatje

* Prej pamjeve të frikshme të Ditës së Gjykimit është edhe kjo:

“Atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet.” (Abese, 34-36)

Njeriu me familjarët e vet mburret, e ka përkrahjen e tyre dhe me ta është më i fuqishëm. Porse Ditën e Kiametit kur të shoh se çfarë po i pret ata, ikën prej tyre.

Në ajet së pari përmendet vëllai, sepse me të është rritur dhe dashuria mes tyre vazhdon gjatë tërë jetës.

Pastaj vijnë prindërit, e që janë më të afërt sesa vëllai.

Në fund vijnë gruaja dhe fëmijët, të cilët janë familja më e lidhur me njeriun.

E tërë kjo pamje tregon për momentet e frikshme të asaj Dite, ku njeriu e ka brengën e vet, dhe ikën nga të afërmit.

Përshatje

* **“Në ditën kur njerëzit ngrihen (prej varrezave) për të dalë para Zotit të botëve.”** (Mutafifin, 6)

Pasi do të qëndrosh e do të dalësh para Tij, atëherë qohu e falu këtu.

Qëndro para Tij, në namaz kur njerëzit flenë.

Që të mund të qëndrosh atje kur njerëzit me llogari janë të zënë.

Përshatje

* **“Ai është Falësi dhe i Dashuri.”** (Buruxh, 14)

Sa i bukur është bashkimi i këtyre dy Emrave të Allahut me një ajet; Ai po i thërret mëkatarët që të pendohen, në mënyrë që t'i fal, e jo vetëm kaq, por edhe t'i dojë ata.

Përktim

* Allahu na tregon për Vetën e Tij: **“Ai është Falësi dhe i Dashuri.”** (Buruxh, 14) Nëse u kërkon falje njerëzve për gabimin e bërë, ndoshta ta falin, por nuk të dhurojnë dashuri. Ndërkaq Allahu, atyre që pendohen, ua pranon, ua falë mëkatin, e madje edhe i do ata.

Përktim

* **“Assesi! Por ju nuk e respektoni jetimin.”** (Fexhër, 17)

Te puna e jetimit, nuk është qëllimi vetëm ta ndihmojmë me ushqim, porse edhe ta respektojmë e ta nderojmë, e ta bëjmë të ndihet krenarë.

Përshtatje

* **“Lexo, se Zoti yt, është më bujari.”** (Alak, 3)

Dija është njëra prej dhuratave më të mëdha të Allahut që ia dha njeriut.

Përkthim

* **“Nata e Kadrit është më e vlefshme se një mijë muaj.”** (Kadër, 3)

Një natë ua tejkaloi një mijë muajve në vlerë. Pra puna nuk qenka me jetë të gjatë, porse me bereqet dhe me vepra të mira.

Përshtatje

* **“Nata e Kadrit është më e vlefshme se një mijë muaj.”** (Kadër, 3)

Ubej ibn Kabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thoshte: “Beto hem në Allahun! Unë e di cila natë është ajo. Atë natë i Dërguari i Allahu na urdhëroi që të falemi natën. Ajo është nata e njëzet e shtatë.” (Muslimi)

Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Atij që falet Natën e Kadrit, duke besuar dhe llogaritur në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës.”

(Buhariu)

* Në suren Fil, Allahu i Madhëruar na tregon se si e shfarosi ushtrinë e elefantit, përmes shpendëve:

“Dhe dërgoi kundër tyre tufa shpendësh, që i gjuanin ata me gurë nga balta e gurëzuar!” (Fil, 3,4)

Pra, Allahu dërgoi shpend kundër elefantëve, që ta dijë besimtari se Allahu e ndihmon kë të dojë me çfarë të dojë. Kur Allahu e ndihmon dikë, mos pyet për sebetet; ndodhë që ta bëjë përmes krijesave shumë të vogla.

Ushtria që ishte nisur drejtë Qabesë, mburreshin me madhështinë e elefantit, porse Allahu i shfarosi me gurë të shpendëve.

Përkthim

* Në suren Fil, Allahu i Madhëruar na tregon për përfundimin e keq të ushtrisë së elefantit:

“Dhe ata i bëri si gjeth i grimcuar (i përtypur)!” (Fil, 5)

Po, gjithsesi Urtësia dhe Butësia e Allahut janë absolute; falë shumë dhe afatizon shumë, porse kur njerëzit e teprojnë dhe shumë e hidhërojnë Atë, atëherë nuk i lë ata në sipërfaqe të Tokës.

Përkthim

* **“A di ti për atë që e përgënjeshton Ditën e llogarisë? Po ai është që dëbon jetimët (në mënyrë të vrazhdë), e as nuk nxit për të ushqyer të varfrin.”** (Maun, 1-3)

Mosbesimi në Ditën e Gjykimit, e prishë edukatën dhe bamirësinë ndaj të tjerëve, sikurse që besimi në Ditën e Gjykimit e rregullon busullën e etikës dhe bamirësisë me të tjerët.

Përkthim

* **“A di ti për atë që e përgënjeshton Ditën e llogarisë? Po ai është që dëbon jetimin (në mënyrë të vrazhdë), e as nuk nxit për të ushqyer të varfrin.”** (Maun, 1-3)

Mohim i Ditës së Gjykimit, e shuan frikën ndaj Zotit dhe mëshirën për krijesat.

Ai që i lë obligimet e Zotit, aq më parë i lë obligimet që i ka ndaj njerëzve.

Përkthim

* Kushdo që e përçmoi Muhamedin ﷺ përgjatë historisë, përfundimi i tij ishte i njollosur:

“E s’ka dyshim se urrejtësi yt është fatprerë.” (Keuther, 3)

Ata që e shanë, e urryen apo e ofenduan, sot as emri nuk u përmendet,

të gjithë ata mbetën në arkiva të harruar.

Përshatje